

ZGJEDHJET 2014: DEMOKRACIA E DISKUALIFIKUAR





ZGJEDHJET

2014

**DEMOKRACIA
E DISKUALIFIKUAR**

Zgjedhjet 2014: DEMOKRACIA E DISKUALIFIKUAR

Boton: CIVIL – Qendra për Liri
Për botuesin: Xhabir M. Deralla

Autorë:

Sasho Ordanoski (redaktor)
Xhabir M. Deralla

Redaksia e CIVIL-it (autorët dhe ekipi projektues):

Sandra Gavrilloska, Meri Jordanovska, Petar Stojković, Arbana Qerimi, Xhelal Hoxhiq, Biljana Jordanovska, Aleksandar Nikoliq Pisarev, Frosina Mitrusheva, Stefan Urxhanovski, Kate Hristovska, Sonja Eftovska, Bunjamin Kamberi, Goran Naumovski, Marko Petrevski

Ballina dhe ilustrimet: Igor Stevkovski

Disenji: Mirosllav Sotjanović dhe Xhabir Deralla

Fotografitë: Stefan Urxhanovski, vëzhgues të CIVIL-it, ekipi projektues, bashkëpunëtorë, qytetarë, arkiva e CIVIL-it
Shtyp TP Dule 99, Shkup

Tirazhi: 200 kopje

Ky publikim u përkrah nga Ambasada e SHBA, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Ambasada Gjermane, Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni, Forumi Servisi Civil Paqesor. Të dhënat dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të CIVIL-it dhe jo domosdoshmërisht i reflektojnë ato të donatorëve.

Ky publikim është në dispozicion në formë të shtypur dhe elektronike (on-line dhe në CD) në maqedonisht, shqip dhe anglisht. CD-ja përmban edhe Kalendarin e ngjarjeve, video, audio dhe fotografi.


Lejohet marrja dhe përdorimi i përmbajtjes ose pjesëve të përmbajtjes së këtij publikimi sipas kushteve të Creative Commons Attribution 4.0 International License.

ISBN-10: 608-65629-3-8

ISBN-13: 978-608-65629-3-9


EAN: 9786086562939



A street scene in a city, likely Tirana, Albania. In the foreground, a woman with long blonde hair is seen from the back, wearing a light blue shirt and jeans. To her right, a man in a white shirt and blue jeans is operating a professional video camera mounted on a tripod. The background shows a paved street with buildings, trees, and a statue of a horse and rider. On the right side of the street, there are several banners for 'CIVIL'. One prominent banner reads 'CIVIL' at the top, followed by 'СЛОБОДНИ ИЗБОРИ ЗГЈЕДНЈЕ ТË ЛИРА' and 'ГЛАСУ СЛОБОДНО, БЕЗ СТРАВ БЕЗ ПРИСМА, БЕЗ НАСИСТВО БЕЗ УЦЕНИ, БЕЗ МАНИПУЛАЦИИ'. Below that, it says 'VOTO LIRSHËM, PA FRIKË PA SFORCIM, PA DHUNË PA KUSHTEZIME, PA MANIPULIME'. The 'CIVIL' logo is also visible at the bottom of the banner.

PËRMBAJTJE | Hyrje **6** | Konteksti i përgjithshëm politik dhe shpallja e zgjedhjeve **8** | Fillim i parakohshëm i fushatave zgjedhore **12** | Shkelja e heshtjes zgjedhore **14** | Anim mediatic dhe mosbalancim propagandistik **15** | Fushata parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale **18** | Ligjshmëria në realizimin e zgjedhjeve **19** | Përdorimi i policisë **23** | Presionet partiake dhe dhënia ryshfet votuesve **24** | Votimi i të burgosurve **26** | Lista Zgjedhore **27** | Votues të paqenë **28** | Sjellje e paligjshme e anëtarëve të këshillave zgjedhorë **34** | Votim publik **35** | CVotim familjar dhe grupor **35** | Përgjigjja e institucioneve **37** | Presione mbi vëzhguesit e Civilit **39** | Civili dhe KShZ-ja **40** | Vëzhgimi pasgjedhor **41** | Implementimi, metodologjia dhe përkrahja e projektit Zgjedhje të Lira 2014 **45** | Ndikimi i Civilit në Internet hapësirën **48**





vjet nga ardhja në pushtet e VMRO-DPMNE-së dhe pas tetë cikleve zgjedhore në të gjitha nivelet e shtetit, përshkrimi më i mirë për gjendjen e tanishme të demokracisë zgjedhore maqedonase është ta pararendoni se ndeshja futbolistike mes konkurrentëve politikë zhvillohet në një terren në të cilin pushteti golin e vet e ka vendosur në maje të bregut, ndërsa shtyllat e opozitës gjenden në një moçal poshtë bregut – gjyqtarët janë të blerë për të anuar nga pushteti, topi është zëvendësuar me një pak hokeji, opozita në vend se me atlete futbollit vrapon përreth me sandale, publiku është kryesisht i përbërë nga nëpunës shtetërorë,

monopolin për shitjen e farave dhe kikirikëve e mban një partner koalicioni më i vogël në pushtet, ndërsa të drejtat për transmetim të drejtpërdrejtë dhe objektiv i ka fituar ekskluzivisht TV Siteli.

Pjesa më e madhe e elementeve të rëndësishme zgjedhore të mbetura – siç janë dimensionet e paravaneve zgjedhor dhe ngjyra e fletëvotimeve – është sipas standardeve të larta zgjedhore skandinavike.



Hyrje

Një shtet në të cilin qeveria i kontrollon të gjithë mekanizmat e fuqisë, duke përfshirë gjyqësorin dhe procesin zgjedhor, nuk toleron asnjë pakicë apo qëndrime të kundërta dhe përdor frikën dhe shqetësimin për realizimin e pushtetit të vet mbi shoqërinë - shkruajti për Balkaninsight¹ kohë më parë nga Brukseli Ervan Fuere, përfaqësuesi i posaçëm i dikurshëm (2005-2011) dhe udhëheqës i Zyrës së Delegationit të Bashkësisë Evropiane në Shkup. Fuere konkludon se “demokracia e humbi kuptimin e vet në Maqedoni”.

Ky është, ndoshta, përshkrimi më i shkurtër, por më i saktë dhe gjithëpërfshirës i gjendjes me demokracinë maqedonase, i shprehur nga një mik dashamiras dhe shumëvjeçar i shtetit maqedonas dhe i njerëzve të cilët jetojnë në të. Në tetë vitet e kaluara Maqedonia ngadalë ecte prapa nga niveli i një demokracie në zhvillim, të pandërtuar deri në fund, me një sërë elementesh zgjedhore të cilat duhej të mbindërtohen me çdo zgjedhje demokratike të ardhshme, në një vend qartë jodemokratik – apo, siç thotë Fridëm Haus² në rangimin e fundit për vitin 2014, në Maqedoni sundon një regjim pseudo-demokratik, të cilin ata e cilësuan si “demokraci hibride” – në të cilën ekzistojnë vetëm disa elemente që përkujtojnë standardet demokratik normal.

Në fakt, edhe në Deklaratën e vet për zbulimet dhe konkludimet nga zgjedhjet në Maqedoni në vitin 2014³, Misioni Ndërkombëtar Vëzhgues i Zgjedhjeve në vend konstatoi zgjedhje të realizuara në mënyrë “efikase”, me shumë vërejtje rreth aspekteve demokratike thelbësore, të cilat janë shkelur (edhe) gjatë këtyre zgjedhjeve maqedonase: përkufizim joadekuat i resurseve dhe aktiviteteve partiake nga ato

¹ <http://www.balkaninsight.com/en/article/democracy-has-lost-its-meaning-in-macedonia>.

² <http://freedomhouse.org/report/nations-transit/2014/macedonia#.U56qsnbm5ws>

³ Deklarata e Misionit të OSBE/ODIHR në vend është publikuar më 28 prill 2014 dhe në tërësi mund të lexohet në www.osce.org/odihr/elections/116272

shtetërore, frikësim i votuesve, presion tej mase mbi votuesit etnikë shqiptarë për bojkot të zgjedhjeve presidenciale, anësi e madhe mediatike në krah të partisë në pushtet dhe kandidatit të saj presidencial, mungesë konsekuence dhe dykuptimësi në rregullativën ligjore zgjedhore, brengë rreth saktësisë së Listës Zgjedhore, joefektivitet i mekanizmit për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore etj.

E tërë kjo ndodh në një atmosferë shumëvjeçare të gjuhës së urejtjes, e promovuar dhe e shtytur drejtpërdrejt nga pushteti, nëpër mediat elektronike dhe të shtypura, nga të cilat pjesa më e madhe ka politika redaktuese nën kontroll të drejtpërdrejtë të pushtetit; në mungesë të dialogut politik, si rezultat i konfrontimit të ashpër mes regjimit dhe opozitës në vend; me parregullsi serioze dhe erozion të standardeve demokratik në të gjitha sferat e funksionimit të një demokracie normale parlamentare. Krahas kësaj, procesi zgjedhor zhvillohet edhe në kombinim të një atmosfere politike tejet të ndezur, të institucioneve të dobëta dhe të partizuara, të një pasigurie sociale dhe varfërie të përhapur, të vetëdijes së ulët qytetare dhe me nxitjen e vazhdueshme të tensioneve etnik.



Konteksti i përgjithshëm politik dhe shpallja e zgjedhjeve

Në këto kushte të përgjithshme në vend, u organizuan edhe zgjedhje presidenciale dhe parlamentare të jashtëzakonshme në vitin 2014. Kriza politike, e cila me intensitet të ndryshëm zgjat më shumë vjet, kulmin e vet e arriti me largimin e dhunshëm të deputetëve opozitarë dhe të gazetarëve nga Kuvendi i Maqedonisë më 24 dhjetor 2012. Kjo ndodhi në ditët kur në Kuvend sillej Buxheti për vitin 2013, ndaj të cilit opozita vrullshëm kundërshtonte dhe, me përdorimin e metodës së filibasting-ut parlamentar, u përpoq ta ngadalësojë, apo ta bllokojë procesin. Zgjedhjet vendore në mars 2013 u zhvilluan në kushte të krizës politike, bojkotit, serisë së protestave dhe ndërmjetësimit intensiv ndërkombëtar diplomatik – në ato zgjedhje, opozita mori pjesë falë presionit të fuqishëm ndërkombëtar mbi të.

Viti pas zgjedhjeve vendore, në të cilat bindshëm triumfoi koalicioni në pushtet në nivel qendror i VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së, rodhi në shenjë të sulmeve të ashpra të ndërsjella, por edhe me rritje të tensioneve ndëretnike, shpeshherë të promovuara nga partnerët e koalicionit në pushtet. Këto trende u përforcuan sidomos pas fillimit të procesit për zgjedhje të kandidatit për kryetar nga radhët e partisë në pushtet VMRO-DPMNE. Pas vendimit të kësaj partie që si adut zgjedhor përsëri ta kandidojë presidentin maqedonas aktual Gjorge Ivanov, koalicioni qeveritar u trondit, sepse VMRO-DPMNE nuk e miratoi kërkesën e partnerit të koalicionit BDI, që në zgjedhje të shkohet me një “kandidat presidencial konsensual”, prapa të cilit do të qëndronte një përkrahje më e gjerë qytetare dhe multietnike. Pasi një krizë e vogël qeveritare, e cila për partitë në pushtet dhe shumicën parlamentare të tyre paraqiste një arsytim të mirë për shpalljen e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme.

Në fakt, shumë analistë politikë të pavarur dhe përfaqësues të shumtë të opozitës komentonin se, për

shkak të mosarritjes së marrëveshjes për një kandidat presidencial të përbashkët "konsensual" nga radhët e qeverisë, e duke e pasur parasysh censusin (40%) të daljes së votuesve në rrethin e dytë të votimit për zgjedhjen e presidentit, VMRO-DPMNE dhe BDI dyshuan në dështimin e zgjedhjeve presidenciale për shkak të bojkotit opozitar të mundshëm të votimit dhe daljes së pamjaftueshme. Për ta përballuar krizën politike në vend, e cila do të pasonte në këtë mënyrë, dhe për të cilën gjë do të ishte vetë fajtorë dhe me pasojat e së cilës vështirë do të ballafaqoheshin, partia maqedonase në pushtet, VMRO-DPMNE, dhe partneri i saj shqiptar në pushtet, BDI, në nivelin më të lartë dhe larg syve të publikut janë marrë vesh për një skenar, i cili do të jetë fitimprurës për të dy strukturat nacionaliste në pushtet: të shkohet edhe në zgjedhje presidenciale edhe parlamentare, me një nivel të lartë të konfrontimit nationalist, të fabrikuar dhe të kontrolluar nga VMRO-DPMNE dhe BDI, rreth "mosmarrëveshjes" për zgjedhje të kryetarit maqedonas etnik "konsensual", që do t'i ndihmonte Ivanovit të rizgjedhet president, por edhe të mbulohen temat zgjedhore të pakëndshme sociale dhe ekonomike, me fjalorin dhe argumentimin e mirënjohur politik të nacionalizmit të fshehur dhe të hapur. Kështu, në mënyrë plotësuese do të përforcohej edhe pushteti i tyre në Kuvend.

Për t'u kuptuar më mirë konteksti politik, social dhe psikologjik, në të cilin përgatiteshin dhe realizoheshin edhe këto zgjedhje në Maqedoni, mjaft ilustruese janë të dhënat e një hulumtimi të paradokshëm të OJQ Qendra Maqedonase për Arsimim Evropian (QMAE), për ndjenjën e lirisë dhe frikës te qytetarët e Maqedonisë⁴. Hulumtimet e QMAE tregojnë se 53% të të përfshirëve konsiderojnë se qytetarët e Maqedonisë nuk e shprehin lirshëm mendimin e vet, ndërsa 81,3% nga ata që mendojnë në këtë mënyrë "kanë frikë nga pasojat për ta dhe familjen e tyre". Një shumicë prej 63,6% të të anketuarve janë të bindur se "shërbimet sekrete në Maqedoni përgjojnë komunikimin mes njerëzve të cilët i konsiderojnë kundërshtarë", ndërsa vetëm 20% nuk besojnë në këtë gjë. Me një frikë të personalizuar të këtyre te qytetarët dhe ndjenja e pasigurisë personale, nuk habit që madje 57,7% të të anketuarve janë të bindur se pushteti në Maqedoni ka mënyrë për të kuptuar se si ata vetë votojnë në zgjedhje.

Në një kontekst të këtyre shoqëror dhe politik, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Trajko Veljanovski, i shpalli zgjedhjet presidenciale më 1 shkurt të këtij viti. Sipas renditjes zgjedhore, rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale u caktua për 13 prill, ndërsa rrethi i dytë për 27 prill 2014. Sipas mar-

⁴ Maricij, B., dhe Petkovski, L., "Eurometar", dokument pune në të cilin janë publikuar të dhënat preliminare nga anketa e realizuar nga QMAE 01.03.-19.03.2014 në Maqedoni, me shembull reprezentativ prej 1.200 të anketuarve.

rëveshjes së arritur paraprakisht mes VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së, më 6 mars Veljanovski shpalli edhe zgjedhjet parlamentare të parakohshme për 27 prill, të njëjtën ditë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Pasi u shpallën zgjedhjet, Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ) i shpalli afatet ligjor për fillimin e fushatave parazgjedhore: për zgjedhjet presidenciale, fushata filloi më 24 mars, ndërsa për zgjedhjet parlamentare të parakohshme, më 5 prill 2014.



**Mos ndal këtu,
vazhdo të lexosh!**





Fillim i parakohshëm i fushatave zgjedhore

Me tetë zgjedhje të realizuara – dy herë vendore, dy herë presidenciale dhe madje katër herë parlamentare të rregullta dhe të jashtëzakonshme – në tetë vjet që kur VMRO-DPMNE është në kontinuitet në pushtet (2006-2014), shoqëria maqedonase gjendet në gjendje të fushatës zgjedhore permanente. Mobilizimi i vazhdueshëm partiak-politik është një nga kushtet e rëndësishme të popullizimit sundues të djathtë në vend. Partia në pushtet është vazhdimisht e pranishme në terren, me mikro-menaxhim të nevojave të anëtarësisë dhe të simpatizantëve të vet, por edhe i një numri të madh të qytetarëve të Maqedonisë, partiakisht të papërcaktuar, të cilët nëpërmjet partisë në pushtet përpiqen t'i zgjidhin problemet e mëdha sociale dhe ekonomike të përditshmërisë së tyre – zgjedhjet e reja janë gjithnjë një shans për përforsimin e shtetit klientelistik dhe premtime të reja për punësim në sektorin publik, për pagesën e subvencioneve të premtuara dhe të mbetura ndaj bujqve, për avancimin e burokracisë në nivel vendor dhe shtetëror, për keqpërdorim tjetër të papenguar të të gjitha resurseve shtetëror për qellime partiake zgjedhore, por edhe për injektimin e parave “të freskëta” nga Buxheti shtetëror nëpër organizatat dhe strukturat vendore partiake të partive në pushtet, sidomos ato të VMRO-DPMNE-së. Për shkak të intensitetit dhe numrit të madh të zgjedhjeve, kryeministri dhe ministrat, drejtorët e ndërmarrjeve publike, udhëheqësit e organeve apo institucioneve shtetërore të tjera, janë në një aktivitet të vazhdueshëm parazgjedhor, ku është vështirë të përkufizohet se ç’janë aktivitete shtetëror, e ç’janë aktivitete partiak nga ata që i realizojnë.

Në këtë kuptim, fillimi i parakohshëm i fushatës politike edhe në këto zgjedhje është problem evident, edhe pse është vështirë të përcaktohet se kur vërtet fillon fushata, sepse shoqëria maqedonase me vite me radhë është një cak i fushatës propagandistike agresive partiake-qeveritare.

Njëkohësisht, ishte e vështirë të ndahet fushata për kandidatin presidencial nga fushata partiake për zgjedhjet parlamentare, sidomos në rastin e partisë në pushtet VMRO-DPMNE, madje në dy kahje. Kandidati presidencial i VMRO-DPMNE-së zhvillonte një fushatë në emër të partisë, ndërsa vetë partia e promovonte programin parazgjedhor në mënyrë paralele me fushatën presidenciale, duke e mbuluar "insuficiencën" e tij politike te votuesit potencialë.

Edhe pse në një masë më të vogël, edhe LSDM-ja zhvillonte një fushatë në të cilën, në momente, ishte e vështirë të ndahet fushata presidenciale nga ajo parlamentare. Të dy partitë e shkelën afatin ligjor me fillimin e parakohshëm të takimeve të tyre me qytetarët dhe me ngjarje më të vogla anembanë vendit. Edhe partitë GROM dhe PDSH, të cilat dolën me kandidatë të vetët presidenciale, e filluan fushatën para afatit të caktuar me ligj.

Shkelje të praktikës demokratike, por edhe të rregullativës ligjore, në këtë kontekst, bëri edhe BDI-ja. Me arsyetimin e pakënaqësisë nga mospranimi i konceptit për një "kandidat presidencial konsensual", BDI bëri thirrje për bojkot të zgjedhjeve presidenciale dhe organizoi një sërë ngjarjesh në vend, në të cilat e paraqiti konceptin e vet për thirrje për bojkot, me atë që nuk ishte e qartë se a realizon njëkohësisht edhe fushatë për zgjedhjet parlamentare të parakohshme. Pastaj, kjo fushatë gjatë zgjedhjeve do të rritet në bllokim aktiv të së drejtës së votuesve të dalin në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale.



Shkelja e heshtjes zgjedhore

Gjatë tërë procesit zgjedhor, duke përfshirë edhe ditët e votimit, haptazi shkelej heshtja zgjedhore në vend



Agjitim më të dukshëm dhe të hapur bënin aktivistët partiakë të VM-RO-DPMNE-së, duke shpërndarë material propagandistik, me agjitim nga dera në derë, agjitim para vendvotimeve, në rrjetet sociale, si dhe me dhënie ryshfet votuesve në ditët e votimit më 13 dhe 27 prill.

Është ilustrativ rasti i lëshimit të letrës me përkrahje të kandidatit presidencial Gjorge Ivanov votuesve, të nënshkruar me emrin dhe pozitën e kryetarit të komunës së Shkupit – Aerodrom, Ivica Konevski, gjatë heshtjes zgjedhore. Përveç shkeljes së heshtjes zgjedhore, kjo paraqet edhe keqpërdorim të resurseve publike, gjegjësisht të pozitës së kryetarit të komunës, për qëllime partiake.

Në një masë më të vogël dhe me intensitet më të ulët, vëzhguesit e Civilit shënuan shkelje të heshtjes zgjedhore edhe nga aktivistët partiakë të LSDM, BDI, PDSH, GROM dhe Lëvizja Popullore e Maqedonisë.



Anim mediatik dhe mosbalancim propagandistik

Që nga fillimi i periudhës parazgjedhore, përfaqësimi mediatik i VMRO-DPMNE-së në pushtet, ishte pakrahasueshëm më i madh nga të gjitha partitë e tjera së bashku. Fushata e VMRO-DPMNE-së u shoqërua me një gjuhë jashtëzakonisht të vrazhdë dhe me diskualifikime në llogari të LSDM-së opozitare, si dhe me një retorikë nacionaliste agresive, të drejtuar kundër partnerit të koalicionit BDI. Theksi në paraqitjet publike të liderit të VMRO-DPMNE-së u vu mbi thirrjen që të votohen 62 deputetë në Kuvend, “që askush të mos mund t’i kushtëzojë maqedonasit”.

Në kulmin e të gjitha kërcënimeve pas procesit zgjedhor në vend, u bë e qartë se çështjet etnike përsëri bëhen temë dominuese, duke i kërcënuar marrëdhëniet veçmë të brishta ndëretnike, me mundësi reale për shkallëzim dhe përkeqësim të gjendjes për një kohë të gjatë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Edhe në kontekst mediatik, keqpërdorimi i resurseve publike (programet e servisit radiodifuziv publik RTVM) ishte evident edhe para fillimit zyrtar të fushatës.

Mosbalancimi dhe animi nga pushteti në raportet e pjesës më të madhe të medias në vend edhe në këto zgjedhje e shënuan fushatën zgjedhore. Një pjesë e madhe e arsyeve për këtë qëndron edhe te fuqia financiare e partisë në pushtet dhe përfitimi i drejtpërdrejtë që kanë pronarët e medias me përkrahjen e pushtetit në zgjedhje. Kjo është evidente kur bëhet analizë e reklamave të plasura nga ana e pushtetit (VMRO-DPMNE), në, për shembull, shtypin në Maqedoni.

Analiza kuantitative për reklamat e publikuara në gazetatat ditore gjatë tërë fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, tregon një dallim mbresëlënës në fuqinë propagandistike të pushtetit dhe pafuqinë e opozitës në pjesën etnike maqedonase të skenës politike në vend⁵. Kur gjatë

⁵ U analizuan shpalljet në gjashtë gazeta ditore që botohen në gjuhën maqedonase: “Utrinski Vesnik”, “Nova Makedonija”, “Dnevnik”, “Sloboden Peçat”, “Vest” dhe “Veçer”. Në gazetatat ditore në gjuhën shqipe “Koha” dhe “Lajm” gjatë zgjedhjeve nuk janë publikuar reklama të shtypura për kandidatët të cilët garonin në garën zgjedhore.

ditëve të fushatës zgjedhore do të mbliidhen të gjitha publikimet e mëvetësishme në një (1/1) faqe dhe në gjysmë (1/2) faqe për kandidatët presidencialë dhe për deputetë dhe banerat reklamues të publikuar (të cilët në të shumtën e rasteve u publikuan në faqet e para të gazetave), shpërndarja e reklamave në shifra duket siç vijon:

| | 1/1 | 1/2 | Baner |
|------------------------|-----|-----|-------|
| UTRINSKI VESNIK | | | |
| VMRO-DPMNE | 63 | 18 | 24 |
| LSDM | | 1 | |
| GROM | 20 | | |
| DNEVNIK | | | |
| VMRO-DPMNE | 73 | 23 | 31 |
| GROM | 10 | | |
| VEST | | | |
| VMRO-DPMNE | 59 | 17 | 18 |
| PKM | | 3 | |
| GROM | 12 | | |
| VEÇER | | | |
| VMRO-DPMNE | 61 | 23 | 26 |
| SLLOBODEN PEÇAT | | | |
| LSDM | 23 | | 24 |
| PKM | 2 | 4 | |
| NOVA MAKEDONIJA | | | |
| VMRO-DPMNE | 68 | 15 | 24 |
| PKM | | 21 | |

Në mënyrë tabelare, të dhënat e përgjithshme duken siç vijon:

| NUMRI I PËRGJITHËM I SHPALLJEVE | 1/1 | ½ | Baner |
|---------------------------------|-----|----|-------|
| VMRO-DPMNE | 324 | 96 | 123 |
| LSDM | 23 | 1 | 24 |
| GROM | 42 | | |
| PKM | 2 | 29 | |

Nga këto të dhëna shihet se relacioni propagandistik mes dy konkurrentëve kryesorë për marrjen e pushtetit në vend – koalicionet e udhëhequra nga VMRO-DPMNE dhe nga LSDM – është në raport 16:1⁶, gjegjësisht se në çdo faqe të plotë të publikuar me reklamë zgjedhore partiake të opozitës (vetëm në gazetën "Slloboden pečat"), pushteti është përgjigjur me madje 16 shpallje të veta (në pesë gazeta ditore)! Një disproportcion i këtillë propagandistik në shtypin e ditës nuk është vërejtur kurrë në zgjedhje në 24 vitet e fundit, që nga promovimi i demokracisë në Maqedoni.

Në fakt, në raportet e veta zyrtare financiare zgjedhore, VMRO-DPMNE deklaroi se në buxhetin e kombinuar për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare kanë shpenzuar rreth 2 milionë euro, ndërsa te LSDM-ja kjo shifër është përafërsisht 145 mijë euro, që është rreth 13 herë më pak nga buxheti partiak propagandistik i VMRO-DPMNE-së. Çdo koment shtesë është i panevojshëm.

⁶ Raporti është llogaritur në mënyrë që numrit të përgjithshëm të shpalljeve në faqe të plota u është shtuar numri i shpalljeve në gjysmë faqe, i pjesëtuar me dy, të cilët trajtohen si shpallje të plota. Kështu, VMRO-DPMNE-ja gjithsej ka shpallur 372 faqe, përkundër 23 faqeve të LSDM-së. Sa i përket publikimit të banerave, raporti është 5:1 në të mirë të VMRO-DPMNE-së.

Fushata parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale

Fillimin zyrtar të fushatës për zgjedhjet presidenciale e ndjek intensifikimi i keqpërdorimit të resurseve publike për qëllime partiake dhe për mediat. Civili e vëzhgonte fushatën parazgjedhore në tërë vendin nëpërmjet vëzhguesve të vet, por edhe nëpërmjet punës së gazetarëve të redaksisë së Civil Medias, të formuar pak para fillimit të fushatës. Një numër i madh i parregullsive u konstatuan që në fillim të fushatës.

Vetëm në javën e parë pas fillimit zyrtar të fushatës, Civili regjistroi 72 ngjarje parazgjedhore në organizim të VMRO-DPMNE-së (27), të LSDM-së (29), të GROM-it (9) dhe të PDSH-së (7). Në këto tubime politike, partitë i promovonin kandidatët presidencial të vet, por nuk u përmbajtën nga promovimi i vetë partive dhe platformës parazgjedhore të tyre. BDI mbajti 10 tubime në të cilat bënë thirrje për bojkot të zgjedhjeve presidenciale dhe e promovoi programin e vet partiak.

Në pothuajse të gjitha ngjarjet mund të vërehej keqpërdorim i resurseve publike në nivel qendror dhe vendor, sidomos nga ana e partnerëve të koalicionit qeveritar. Edhe në këto zgjedhje, Civili regjistroi praktikën sipas së cilës të punësuarit në administratën publike kanë obligim të agjitojnë dhe të mbledhin publik për rritjen e prezencës në tubimet partiake.

Civili e alarmoi publikun për keqpërdorim të fëmijëve dhe të rinjve në fushatë, sidomos angazhimin e tyre si publik, por edhe për agjitim në rrjetet sociale.

Në raportet e vëzhgues(e)ve të Civilit flitet edhe për krijimin e listave me votues të sigurt, presione mbi votuesit me telefon dhe në vend pune, si dhe për një numër të madh të premtimeve për punësim apo benefite të tjera, siç janë subvencionet për bujqit, ndihma sociale, leja e ndërtimit etj.

Në periudhën nga 20 marsi deri më 11 prill, Civili zbulon edhe një numër të madh të votuesve të paqenë në komunat Kisella Vodë dhe Qendër të Shkupit.

Ligjshmëria në realizimin e zgjedhjeve

Praktika (jo)demokratike maqedonase që moti u mësua që zgjedhjet, në kuptimin juridik, të mos shkelen me keqpërdorim apo incidente të tilla drastike, të cilat në mënyrë drastike do ta vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e procesit zgjedhor të përgjithshëm. Në vend të kësaj, gjatë zgjedhjeve, në mënyrë masovike bëhen shkelje “më të imëta” – sidomos nga ana e pushtetit – të cilat, në shikim të parë, nuk janë të natyrës thelbësore, por, në fakt, në masë të madhe kontribuojnë për pozita jokorrekte dhe dukshëm të pabarabarta të pjesëmarrësve në procesin garues zgjedhor.

Sipas raporteve dhe konkludimeve të publikuara të shoqatave dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, gjatë procesit zgjedhor presidencial dhe gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, u konstatuan një sërë lëshimesh juridike. Shumica e tyre përsëriteshin në disa zgjedhje me rend, që flet për tolerim me vetëdije të mosrespektimit të Kodit Zgjedhor, për përfitim politik të atyre të cilët kanë fuqinë të ndikojnë mbi organizimin e zgjedhjeve.

Ndër problemet të cilat përsëriten me vite janë lëshimet në evidencën e së drejtës së votimit, lidhur me anomalitë në Listën Zgjedhore. Në këtë kuptim, Civil i konstaton problemet në vijim:

- mospërputhje të ekstrakteve të Listës Zgjedhore për zgjedhjet që realizoheshin njëkohësisht – të rregulltat presidenciale dhe të jashtëzakonshmet parlamentare;
- mospërputhje të on-line versionit të Listës Zgjedhore dhe ekstrakteve nga Lista Zgjedhore për njësi zgjedhore të caktuara, për disa komuna dhe vendvotime;
- evidencë e gabuar e personave të vdekur dhe “votues të paqenë” në Listën Zgjedhore, si qytetarë të cilët kanë të drejtë vote.

Ditën e zgjedhjeve, edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të votimit, Civili konstatoi lëshime në punën e këshillave zgjedhorë, të cilët në të shumtën e rasteve kishin të bëjnë me kontroll jo të drejtë dhe vërtetim të identitetit personal të votuesve; evidencë jo e drejtë – regjistrim të votuesve në ekstraktin

e Listës Zgjedhore; moslargimi i materialeve propagandistike partiake nga vendvotimet; mossigurimi i rregullsisë dhe fshehtësisë së votimit; dhe, mossigurimi i mbajtjes së lirë dhe të qetë të votimit.

Edhe në këto zgjedhje mund të dëshmojnë një sërë lëshimesh në mënyrën e votimit, të cilët paraqesin shkelje të parimit të së drejtës së barabartë të votimit. Kështu, si dhe në shumë zgjedhje të mëparshme, ishin të shpeshtuara rastet e votimit familjar apo grupor, në vend të votimit vetanak; të votimit publik, në vend të votimit të fshehtë; mobilizim dhe agjitim mes votuesve; si dhe raste të kërcënimeve, gjegjësisht dhënies ryshfet votuesve.

Lëshimet në fushatën zgjedhore kishin ndikim shumë të dëmshëm mbi zhvillimin korrekt të zgjedhjeve. Pushteti edhe këtë herë nuk ngushtohet të bëjë pagesa masovike nga mjetet buxhetore apo nga mjetet e fondeve publike të shtetit, gjatë fushatës zgjedhore. Shkeljet juridike të dispozitave të Kodit Zgjedhor ishin të shumta dhe për shkak të prezantimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore gjatë heshtjes zgjedhore, si dhe me raportimin mediatik në funksion të përkrahjes së qartë të një fushate zgjedhore të caktuar, me të cilën ndikohej në mënyrë të paligjshme mbi vendimin e votuesve. U vërejtën raste të vendosjes së pllakateve të fushatave partiake në vendvotime, si dhe largim i pllakateve zgjedhore apo ngjitje të materialeve propagandistike të veta mbi pllakatet e pjesëmarrësve të tjerë në fushatën zgjedhore.

Në këto zgjedhje, me raste të shumta të shkeljes së vrazhdë të rendit dhe qetësisë në vendvotime dhe paraqitje e personave të paautorizuar, madje edhe personave të armatosur në objektet dhe vendet ku realizohej votimi dhe në afërsi të tyre, në mënyrë serioze u vu në pikëpyetje roli dhe puna e policisë. U vërejtën raste të sjelljes injorante (mungesë reaksioni) të policisë pas denoncimeve për shkelje të rendit dhe qetësisë në vendvotime, demolime të shtabeve zgjedhor, konflikte fizike mes aktivistëve të partive të ndryshme, nga njëra anë, si dhe intervenime tendencioze nga ana e policisë, nga ana tjetër.

Në kontekstin e shkeljeve juridike të rregullativës zgjedhore duhet të shënohet edhe se fëmijët dhe të rinjtë keqpërdoreshin në mënyrë sistematike gjatë tërë fushatës zgjedhore. Partitë në mënyrë masovike i dërgonin nëpër qytete për të marrë pjesë në tubime dhe konventa partiake, madje në kohën e paraparë për qëndrim në shkollë. Në rrjetet sociale, fëmijët dhe të rinjtë paraqiteshin të veshur me shenja partiake. Gjatë aktiviteteve partiake në terren, fëmijët dhe të rinjtë mbanin flamuj. Kjo sidomos vërehej në paraqitjet partiake të VMRO-DPMNE-së dhe PDSH-së, ndërsa të mitur me bluza dhe shenja të tjera partiake mund të vëreheshin te VMRO-DPMNE, LSDM, PDSH dhe BDI.

Në këto zgjedhje për herë të parë vëzhguesit e Civilit vërejtën edhe një parregullsi serioze lidhur me

keqpërdorimin politik të fëmijëve, gjegjësisht të të miturve: në vendvotimin numër 0337 në Gjevgjeli, u vërejtën të mitur duke votuar.

Gjatë zgjedhjeve, institucionet shtetërore dhe administrata publike, në masë të madhe, u vunë në funksion të pushtetit, gjegjësisht të partive politike qeveritare dhe interesave zgjedhore të tyre. U vërejt një aktivitet partiak i theksuar i të punësuarve në administratën shtetërore gjatë tërë procesit zgjedhor, nëpërmjet kryerjes së obligimeve dhe detyrave partiake, sikur janë obligime dhe detyra pune.

Vërejtjet e shumta për parregullsitë gjatë procesit zgjedhor, të dorëzuara nga ana e Civilit deri te Komisioni Shtetëror Zgjedhor, u trajtuan vetëm si informata "të paobligueshme". Ato fare nuk u shqyrtuan, e as që u morën parasysh gjatë formimit të notës së KShZ-së për procesin zgjedhor, e as gjatë vendimarrjes së KShZ-së pas vërejtjeve të dorëzuara (madje në bazë të kontrollit të materialit zgjedhor dhe dëshmive të tjera, në pajtim me Kodin Zgjedhor), me të cilën gjë, edhe në këto zgjedhje, u vu në pikëpyetje mbrojtja juridike e së drejtës zgjedhore.



Gjatë zgjedhjeve,
institucionet shtetërore
dhe administrata
publike u vunë
në funksion
të pushtetit

Mos kapërce
faqe! Do të të thirri në
bisedë informative!



Përdorimi i policisë

Pjesëmarrja e madhe e policisë, diku edhe me njësi të posaçme dhe me autoblanda para vendvotimeve, implikon tensionim, mungesë të atmosferës demokratike dhe është shqetësuese për votuesit. Posaçërisht problematike ishte prania e policëve të armatosur në vetë vendvotimet. Kjo gjendje rezulton me tensionim gjatë tërë ditës zgjedhore, sidomos në ditën e votimit më 27 prill.

Sipas raporteve të vëzhguesve tanë, si dhe të burimeve të tjera, prania e rritur e policisë u regjistrua në Strumicë, Tetovë, Manastir, Butel, Qendër, Çair, Aerodrom dhe Haraçinë. Prani e policëve të armatosur brenda, në ambientet ku gjenden vendvotimet, u regjistruan në Shtip, Demir Kapi, Karposh, Aerodrom, Çair dhe Manastir.

Në disa raste policia edhe në mënyrë aktive ndërmerre masa lidhur me ngjarjet zgjedhore në ditën e votimit. Kështu, kryetari i komunës së Kumanovës, Zoran Damjanovski nga opozita, dhe disa aktivistë të LSDM-së, u morën në stacion të policisë më 27 prill, gjegjësisht u thirrën në bisedë informative, me arsyetimin se e shkelin heshtjen parazgjedhore. Kandidati për deputet i Lëvizjes Popullore të Maqedonisë, Sashe Ivanovski, më 12 prill u mor në stacionin e policisë në Sveti Nikollë, për shkak të shkeljes së heshtjes zgjedhore. Për atë se si policia u përdor për qellime partiake të partisë në pushtet, flet edhe raporti nga Kumanova, më 27 prill, në ora 14,30: "Aktivistë partiak edhe të DPMNE-së edhe të LSDM-së transportojnë votues deri te vendvotimet. Deri para orës 14, nuk ka fare probleme, por tani policia filloi të ndalojë dhe të kryejë kontroll. I ndalon ata të cilët transportojnë persona për të cilët supozohet se janë votues të LSDM-së, ndërsa automjetet të cilët transportojnë votues të VMRO-DPMNE-së lëshohen".

Presionet partiake dhe dhënia ryshfet votuesve

Në këto zgjedhje vëzhguesit e Civilit vërejtën një sërë shembujsh dhe formash të presionit mbi votuesit nga ana e partive, sidomos nga radhët e koalicionit në pushtet. Për shembull, gjatë fushatës parazgjedhore në komunën e Velesit u regjistruan një sërë rastesh të presionit mbi votuesit. Mes tjerash, u vërejtën raste të mosdhënies së ndihmës mujore pjesëtarëve të kategorive sociale, me arsyetimin se nuk kanë dorëzuar dokumentet me kohë – ndërsa, sipas dëshmimeve nga terreni, bëhet fjalë për persona të cilët janë me orientim opozitar ose i takojnë kategorisë së votuesve të papërcaktuar. Në këtë komunë u regjistruan edhe praktika korruptive me ndarjen e kompensimit në para për punëtorët e ndërmarrjeve të falimentuara, si dhe subvencione vreshtarëve. Pothuajse në tërë vendin u jepej ryshfet votuesve. Vëzhguesit tanë raportnin për dhënie nga 500 denarë për votë në zgjedhjet presidenciale dhe nga 500 denarë për votë në zgjedhjet parlamentare, nga ana e anëtarëve të VMRO-DPMNE-së. Kjo gjë u regjistrua në Strumicë, Sveti Nikollë, Koçan, Kërçovë, Kumanovë, Manastir dhe në Shuto Orizar, por edhe në disa komuna të tjera, të cilat, për shkak të rezikut nga zbulimi i identitetit të burimeve tona dhe frikës se do të ballafaqohen me hakmarrje, këto komuna nuk do t'i paraqesim në këtë publikim. Në shumë vende, votuesit e “stimuluar” në këtë mënyrë, janë transportuar në mënyrë të organizuar deri te vendvotimet.

Aktivistët partiak të VMRO-DPMNE-së, LSDM-së, BDI-së dhe PDSH-së, transportonin votues me mjete të ndryshme, duke përfshirë edhe rastin e një traktori “partiak”. Automjetet për këtë qëllim në Shuto Orizar ishin të shënuara me simbole partiake të VMRO-DPMNE-së. Transport votuesish është vërejtur edhe në komunat Kërçovë, Resnjë, Staro Nagoriçan, Radovish, Veles, Demir Kapi, Gjevgjeli, Sveti Nikollë, Koçan, Aerodrom dhe Gazi Babë. Në Aerodrom dhe në Gazi Babë janë regjistruar kolona me nga 20 automjete të mbushura me votues.

Janë vërejtur edhe raste kur votuesve “të dëgjueshëm” nuk u janë dhënë para në dorë, por u janë dhënë të mira materiale, si dhe vauçerë për blerje në shitoret lokale, siç është rasti në Sveti Nikollë, kur votuesve të blerë u është mundësuar, si kompensim për përkrahjen e kandidatëve të një partie të caktuar, të blejnë produkte në vlerë prej 2.000 denarësh në shitoren e mëhallës.

Gjatë fushatës kishte edhe punësime dhe premtime për punësim. Vëzhguesit e Civilit e hulumtuan rastin me punësimet në “Jugohrom” të Tetovës pak para zgjedhjeve. Të punësuar në këtë kombinat na pohonin se ata janë nën presion të madh për të votuar për partinë në pushtet.

U regjistruan edhe raste në të cilët votuesit kanë qenë nën kërcënime të ndryshme. Letërnjoftime të votuesve janë marrë nga policia apo nga aktivistët partiakë të VMRO-DPMNE-së, me qëllim që të sigurojnë votim të sigurt në komunat Shuto Orizar, Kisella Vodë, Manastir dhe Strumicë.



Foto e “vauçerit# prej 500 denarë, kompensim për të votuar; dhënë një vëzhguesi të Civilit

Votimi i të burgosurve

Edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve, një i burgosur në burgun e Prilepit nuk u gjend në listën zgjedhore dhe nuk mundi ta realizojë të drejtën e tij për të votuar. “Krahas asaj që njerëzit kompetentë e morën obligimin ta përmirësojnë gabimin, kjo megjithatë nuk u bë. Arsyetoheshin se ata kanë bërë gjithçka që kanë mundur të bëjnë. Vjet votova në burgun hetues, ndërsa sivjet, sipas bashkëshortes, kam qenë në listën zgjedhore në vendin ku jetoj”, thotë burimi ynë nga burgu.

Civili konstatoi edhe mangësi gjatë votimit në burgun e Shtipit, ku, sipas informatave tona, të burgosurve u kanë sugjeruar për cilën parti politike dhe për cilin kandidat të votojnë. Të burgosurve u jepej ryshfet për të votuar për VMRO-DPMNE-në, duke u dhënë sapun, dy oblanda dhe nga dy brisqe për rruajte. Janë blerë edhe me nga 100 gramë kafe, lëng dhe napolitanka.

Parregullsi të ngjashme gjatë votimit të të burgosurve janë regjistruar edhe në burgun Shuto Orizar në Shkup.



Lista Zgjedhore

Dilemat rreth përfshirjes dhe sigurisë së Listës Zgjedhore në Maqedoni janë të katomshme, ndërsa sivjet u ashpërsua polemika publike ndërinstucionale për atë se kush është kompetent për përgatitjen e listës së votuesve të azhurnuar në vend. Përderisa Ministria e Punëve të Brendshme përgjegjësinë në tërësi ia hedh Komisionit Shtetëror Zgjedhor, kryetari i Komisionit, Nikolla Rillkovski, deklaroi se KShZ i ka “duart e lidhura” kur bëhet fjalë për listën, sepse ata nuk mund të bëjnë asnjë “kontroll plotësues” për validitetin e të dhënave të fituara nga institucionet e shtetit.

Është e vërtetë se në nenin 41 të Ligjit Zgjedhor shkruan se për Listën Zgjedhore përkujdeset KShZ, por neni 43 përcakton se MPB-ja i dorëzon KShZ-së të dhëna për qytetarët të cilët kanë mbi 18 vjet dhe kanë letërnjoftim valid, si dhe për persona që kanë vdekur, për banorë të rinj dhe të shpërngulur në/nga një komunë e caktuar, të cilët e kanë ndryshuar emrin apo mbiemrin, të cilët kanë fituar apo humbur shtetësinë, për ata që janë me punë apo qëndrim të përkohshëm jashtë vendit etj. Numri i madh i këtyre rasteve për të cilët është kompetente MPB-ja e imponon dilemën për rregullsinë e të dhënave me të cilat disponon, e nuk mund t’i kontrollojë KShZ-ja. Si rezultat i kësaj, edhe në këto zgjedhje Civili regjistroi probleme serioze me evidencën zgjedhore në të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë në dy ciklet zgjedhore. Kjo anomali sistemore përsëri hodhi një hije të rëndë mbi procesin zgjedhor në tërësi. Problemet manifestoheshin në mënyra të ndryshme. Për shembull, kishte numër të madh të rasteve kur votuesit kanë mundur të votojnë për zgjedhjet parlamentare dhe kanë munguar në listat për zgjedhjet presidenciale, dhe anasjelltas.

Në raporte të shumta të vëzhguesve të Civilit flitet për votues të cilët nuk janë gjetur në Listën Zgjedhore. Një pjesë e tyre raportojnë se e kanë gjetur veten në versionin on-line të Listës Zgjedhore, por nuk kanë qenë të regjistruar kur kanë shkuar të votojnë në vendvotim. Janë regjistruar edhe raste kur votues të cilët kanë votuar për zgjedhjet parlamentare në një komunë, t’i udhëzojnë të votojnë për zgjedhjet presidenciale në një komunë tjetër.

Votues të paqenë

Por, Lista Zgjedhore në Maqedoni ka edhe një specialitet të rrallë: disponon me votues të cilët janë të regjistruar në Listën Zgjedhore, edhe pse në realitet nuk ekzistojnë – këta votues Civilit i quajti të paqenë (fantomik). Vetëm në bazë të hulumtimit dyjavor të Civilit, të bazuar mbi raportet e vëzhguesve të vet në terren, nga shkresat e qytetarëve dhe nga ekipi i gazetarëve të Civilit, mund të konstatohet ekzistimi i disa mijëra rasteve me votues të paqenë, të cilët nuk kanë vendbanim fizik, por kanë letërnjoftime me adresa të Shkupit, gjegjësisht figurojnë në Listën Zgjedhore. Një pjesë e këtyre votuesve janë persona me prejardhje etnike maqedonase nga fshati Pustec i Shqipërisë, ndërsa një pjesë vijnë nga komuna të tjera të Maqedonisë.

“Intervenimi” demografik në zgjedhjet maqedonase për herë të parë u zbardh dhe u dokumentua nga ana e Civilit dhe disa media të pavarura në zgjedhjet lokale në vitin 2013. Në atë kohë, manifestimi më i qartë i këtij manipulimi të vrazhdë ndodhi gjatë votimit në Komunën Qendër të Shkupit. Ky “fenomen” u regjistrua edhe në zgjedhjet e dyfishta të sivjetme. Deri më sot nuk janë të njohura në tërësi mënyrat me të cilat banorë të Pustecit të Shqipërisë ia dalin të gjenden në Listën Zgjedhore në Maqedoni. Por, prania e tyre është e evidente dhe është pjesë e procesit zgjedhor në vend. Përkundër bërjes me dije nga ana e Civilit dhe të mediave të pavarura, si dhe nga partneri i koalicionit në Qeveri, BDI, deri më sot nuk është ndërmarrë ndonjë aksion juridik për pastrimin e këtyre rasteve.

Sivjet, sipas burimeve të Civilit, votuesit nga Pusteci së pari kanë votuar një ditë më parë në Tiranë, si pjesë e diasporës, dhe të nesërmen e kanë kaluar kufirin me Maqedoninë dhe me transport të organizuar dhe me koordinim partiak, të votojnë në Strugë, Resnjë, Manastir, Kërçovë dhe Shkup.

Sipas raportit të një vëzhguesi të Civilit, në vendvotimin numër 1642 në Resnjë, janë shfaqur katër votues nga Pusteci. Në letërnjoftimet e tyre ka shkruar se ata jetojnë në rrugën “Boris Kidriç” p.n. në Resnjë. Kjo rrugë ekziston, por numri i vendbanimit është i panjohur. Sipas raportit të vëzhguesit të Civilit në Resnjë, shumica e votuesve të paqenë kanë qenë të regjistruar në këtë mënyrë, vetëm me emrin e rrugës, por jo edhe me numrin e vendbanimit.

Vëzhguesit tanë në Kërçovë vërejtën votim të personave nga Pusteci, të cilët ditën e zgjedhjeve parlamentare, në ora 13, me autobus janë sjellë në afërsi të vendvotimit numër 0279 dhe pastaj me automjete janë shpërndarë për të votuar në lokacione të ndryshme të komunës. Edhe kryetari i Komunës së Kërçovës, Fatmir Dehari, në deklaratën para kamerës së Civilit dëshmoi për votimin e personave nga Pusteci në komunën e tij.

Në vendvotimin numër 2849 në Komunën Qendër, është shfaqur një votues nga Pusteci për të votuar me gishta veçmë të ngjyrosura në të dy duart. Ka patur reagim nga ana e Këshillit Zgjedhor, ndërsa votuesi me vrap është larguar nga vendi.

Një votues nga Pusteci me gishtat e mëdhenj të shënuar në të dy duart është përpjekur të votojë edhe në Komunën Kisella Vodë të Shkupit (në vendvotimin numër 2849), ndërsa votues nga Pusteci janë vërejtur edhe në ShF "Vëllezërit Milladinov" në Komunën Aerodrom të Shkupit, si dhe në më shumë vendvotime në Komunën Butel. Janë sjellë dhe janë shpërndarë me furgona me targa shqiptare, për të cilën gjë ekziston edhe foto-dokumentacion.



Rr. Mihail Çakov nr. 7, Kisella Voda

Sipas një vëzhguesi të Civilit, më 26 prill (e shtunë), një ditë para votimit, para Stacionit Policor nr. 1 (i njohur si SP Beko) në Komunën Qendër të Shkupit, u janë shpërndarë letërnjoftime personave që supozohet se janë nga fshati Pustec.


Mbetet e paqartë se sa saktësisht nga këta "të paqenë" kanë votuar në procesin zgjedhor, por numri i tyre shkon në qindra dhe mijëra njerëz, ndërsa me planifikimin dhe shpërndarjen e kujdesshme të votave të tyre "të shtuara" nëpër vendvotime dhe njësi zgjedhore, ata në mënyrë serioze mund të ndikojnë mbi rezultatet zgjedhore përfundimtare. Të përmendim se ky devi-

jim zgjedhor është së paku pjesërisht i mundësuar dhe, nga rastet e shumta, të regjistruara edhe nga vëzhguesit e Civilit edhe në rrethin e parë zgjedhor për zgjedhjet presidenciale edhe në ditën e votimit në rrethin e dytë, gjegjësisht në zgjedhjet parlamentare, për problemet me ngjyrën e cila fshihej menjëherë pas shënimit të një pjesë e votuesve të cilët veçmë kanë votuar. Ky problem u vërejt në të gjitha komunat në Maqedoni.

Se bëhet fjalë për shumë raste të votuesve "të paqenë" dhe "të shpikur", këtu do të paraqesim rreth dhjetë shembuj karakteristikë...

Në rrugën e Shkupit "Petar Deljan" në Komunën e Kisella Vodës u zbulua se në ndërtesa me nga dy hyrje dhe me nga 17 banesa në çdo hyrje (domethënë, në tërësi 34 banesa në çdo ndërtesë), sipas Listës Zgjedhore ekzistojnë më shumë hyrje dhe banesa "të shtuara": në çdo hyrje ka nga 25 banesa, ndërsa çdo ndërtesë, në vend dy, ka më shumë hyrje. Kështu, ndërtesa numër 11 në këtë rrugë, sipas Listës Zgjedhore ka madje nëntë hyrje, edhe pse gjatë vëzhgimit në terren Civili konstatoi ekzistimin e vetëm dy hyrjeve në ndërtesë. E ngjashme është edhe gjendja me ndërtesat numër 1 dhe 7. Edhe pse ndërtesa numër 10 në rrugën "Petar Deljan" fare nuk ekziston, në Listën Zgjedhore qëndron si ekzistuese, me shumë "banues votues" në të.

Edhe ndërtesa në rrugën e Shkupit "Mihail Çakov" numër 7 në Komunën Kisella Vodë realisht ka vetëm tri hyrje, ndërsa në Listën Zgjedhore janë shënuar gjashtë! Sipas informatave deri te të cilat arritën vëzhguesit dhe gazetarët e Civilit, në atë rrugë janë zbuluar 15 persona të cilët janë të regjistruar në Listën Zgjedhore, edhe pse adresat e banesave të tyre nuk ekzistojnë.



"Instrukcione"
si të votohet

Pastaj, në rrugën "Pushkini" nr. 2 të Shkupit, në një banesë jeton një familje, ndërsa në adresën e tyre në Listën Zgjedhore janë regjistruar edhe katër anëtarë të një familjeje Pançevski, të cilët kurrë nuk kanë jetuar në këtë adresë. "Nuk e dimë se si ka ndodhur që kjo familje të jetë e regjistruar në adresën e banesës sonë. U paraqitëm gjithkund, por asgjë nuk ndodhi", deklaroi banuesi nga rruga "Pushkini", në adresë të të cilit janë regjistruar katër votues të tjerë.

Civili u përball me një situatë të ngjashme edhe në një banesë të kësaj ndërtese (rruga "Pushkini" nr. 2). Atje jeton një familje katëranëtarëshe, ndërsa në Listën Zgjedhore janë shtatë veta. Është shtuar njëfarë familje Petrushevski. "Nuk e dimë kush janë këta njerëz. Erdhi një herë edhe policia, kontrollonte, u treguam se në këtë banesë nuk jetojnë këta persona", deklaroi banuesi i rrugës "E Pushkinit".

Ndërtesa nr. 2 në rrugën e njëjtë ka dy hyrje, por në Listën Zgjedhore qëndron se kjo ndërtesë ka 3 hyrje. Në hyrjen e tretë, hyrje joekzistuese, në Listën Zgjedhore janë shënuar rreth tridhjetë votues. Sipas burimeve nga terreni, një pjesë e tyre janë me emra dhe mbiemra të huaj.

Raste të këtilla dhe të ngjashme janë regjistruar edhe në komunën Qendër, në rrugët "Aminta i Tretë", "Miroslav Kërlezha", "Orce Nikollov", "Frenklin Ruzvelt", "Uji i Kuq", "Dimitrie Çupovski" (ish-"Velko Vlahoviq"), "Maksim Gorki", "Nikolla Trimpare", "Kiro Kërstevski – Pllatnik", "Kole Nedellkovski", "Petar



Pusteci në komunën e Butelit

Poparsov", "Stale Popov", rruga "Sveti Nikollë", "Vasil Gjorgov", si dhe bulevardet "Ilinden", "VMRO" dhe "Strasho Pinxhur". Nga ky numër i madh i votuesve "të paqenë" të zbuluar në Komunën e Qendrës – dhe kush e di edhe sa të pazbuluar – fitohet përshtypja se në këtë komunë të Shkupit sikur dikush ka ushtruar votim-falcifikim që në kohën e zgjedhjeve vendore të kaluara.

Kështu, për shembull, në rrugën "Vasil Gjorgov" numër 24, në banesën nr. 27, sipas Listës Zgjedhore jetojnë dhjetra persona, të gjithë me të drejtë vote! Nga kontrolli i Civilit në vend, që në derën hyrëse, e cila pothuajse ishte e rrënuar, men-

jëherë mund të vërehej se në atë banesë nuk jeton askush. Të pyetur nga ana jonë, fqinjët dëshmuan se “këtu ka 20 vjet që askush nuk jeton”.

Në rrugën “Fronti Popullor” në lagjen Kapishtec në komunën Qendër, nga ana e majtë e rrugës gjenden ndërtesa shumëkatëshe banimi me numër tek, ndërsa nga ana e djathtë e rrugës nuk ka ndërtesa banimi, por disa lokale hotelerike, auto-lavazhe dhe një garazh parkimi montazhë. Sipas raporteve të mbikëqyrësve të Civilit dhe denoncimeve të qytetarëve, në Listën Zgjedhore atje ka ndërtesa banimi edhe në anën e djathtë të rrugës.

Në rrugën “Kiro Kërstevski – Pllatnik” nr. 11 janë paraqitur se jetojnë mbi 20 persona, të gjithë me të drejtë vote. Kur Civili e vizitoi këtë banesë, derën na e hapi një njeri me moshë mesatare, i cili na deklaroi se është i njoftuar se në banesën e tij janë paraqitur rreth tridhjetë veta, por se rastin nuk e ka denoncuar⁷.

Votues të paqenë u zbuluan edhe në komunën Aerodrom. Ndërtesat në rrugën “ASNOM” nr. 3, 5 dhe 7 (vendvotimi nr. 2708), në rrugën “Vlladimir Komarov” nr. 81 (vendvotimi nr. 2686) dhe në rrugën “Kosta Novakoviç” nr. 21 dhe 51 (vendvotimi nr. 2687 dhe 2688) – në realitet nuk ekzistojnë. Në adresën në bulevardin “Jane Sandanski” nr. 60/2/18, komuna Aerodrom, personi M.Ç. është regjistruar në Listën Zgjedhore në vendvotimin nr. 2754, edhe pse banesa me nr. 18 nuk ekziston.

Votues të paqenë në Listën Zgjedhore para mbajtjes së rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale paraqiten edhe në komunat e Ohrit, Resnjës, Kërçovës, Manastirit dhe Kumanovës. Për shembull, një vëzhgues i Civilit në Manastir lajmëroi se një person ka votuar me letërnjoftim me adresë banimi në rrugën “Mirçe Acev” nr. 31-A, edhe pse pas kontrollit në terren vërtetohet se në atë rrugë me atë numër nuk jeton askush.

Vëzhguesit e Civilit regjistruan edhe raste në të cilat votues të caktuar nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e vet të votës, sepse në vendin e tyre në listën e votimit veçmë është nënshkruar dikush tjetër. Të këtilla janë rastet në Kumanovë (vendvotimi nr. 1000/1) në Komunën e Gazi Babës të Shkupti (vendvotimi nr. 2505) dhe në një sërë vendvotimesh tjera.

Edhe anëtarë të këshillave zgjedhorë janë ballafaquar me votues të cilët kanë patur letërnjoftime me

⁷ Civili e publikoi videon me një pjesë të këtyre dëshmimeve, në sajtin e vet www.civil.org.mk.

adresa banimi identike me të tyret. Rast i këtillë u vërejt në Manastir te dy votues me adresë në rrugën "Dy Gushti" nr. 31 – identike me adresën e një anëtari të Këshillit Zgjedhor në vendvotimin nr. 0060. E njëjta gjë ndodhi edhe në Prilep, ku një votues ka patur adresë e cila përputhet me atë të një anëtari të Këshillit Zgjedhor në vendvotimin nr. 1414. Pa dallim të vërejtjeve të bëra, këtij personi megjithatë i është lejuar të votojë.





Sjellje e paligjshme e anëtarëve të këshillave zgjedhorë

Në praktikën zgjedhore maqedonase u bë pothuajse praktikë e zakonshme leximi me zë i emrit gjatë identifikimit të votuesit, gjë që është e ndaluar me ligj.

Në fshatin Studeniçan, personave të cilët kanë qenë të paraqitur si të sëmurë, ditën e votimit kur votonin të sëmurët dhe të palëvizshmit, anëtarët e Komisionit u kanë dhënë vetëm lista për zgjedhjet parlamentare. Kur disa votues kanë kërkuar të votojnë edhe për kandidatin presidencial, anëtarët e Këshillit Zgjedhor u janë përgjigjur se ato zgjedhje nuk janë të rëndësishme.

Në fshatin Opajë, një votuesi i është thënë nga ana e një anëtarë të Këshillit Zgjedhor se do të pendohet pse ka votuar edhe për kandidatin presidencial, krahas bindjes që të mos e bëjë këtë gjë.

Në fshatin Nerash fare nuk është përdorur markeri për shënimin e atyre të cilët veçmë e kanë shfrytëzuar të drejtën e votës.

Në vendvotimin numër 2146 në Veles, pas intervenimit të kryetares së Këshillit Zgjedhor, të gjithë anëtarët e Këshillit e kanë nënshkruar procesverbalin para përfundimit të numërimit.

Votim publik

Praktikën e paligjshme të votimit publik vëzhguesit e Civilit e vërejtën në Manastir, në vendvotimin nr. 0120/1, në Komunën Gjorçe Petrov, në vendvotimin nr. 2570 dhe nr. 2568, në fshatin Studeniçan, në vendvotimin nr. 2341, si dhe në Kërçovë, në vendvotimin nr. 0279 (në fshatin Lisiçan).

Në fshatin Creshevë, Komuna e Gazi Babës, lista të tëra dhe fletëvotime janë nxjerrë nga vendvotimi dhe janë dërguar në një automjet para vendvotimit. Shoferi i automjetit vetë i ka rrethuar fletëvotimet. Pastaj lista është kthyer prapa, në ambientet e vendvotimit.

Në Studeniçan është regjistruar se paravanet për votim janë të kthyer nga muri, kështu që nga dera hyrëse ka mundur të shihet se kush si voton.

Votim familjar dhe grupor

Votim familjar dhe grupor, si dhe keqpërdorim i asistimit ligjor të paraparë gjatë votimit, u regjistruan në 37 vendvotime, siç janë komunat: Haraçinë, Manastir, Veles, Gjevgjeli, Gradsko, Demir Kapi, Demir Hisar, Karposh, Kisella Vodë, Kërçovë, Koçan, Kumanovë, Prilep, Probishtip, Rankovc, Resnjë, Sveti Nikollë, Nagoriçan i Vjetër, Studeniçan, Çair, Shtip dhe Shuto Orizar.

Një votues në Studeniçan në vendvotimin nr. 2346 ka nxjerrë 7 letërnjoftime, pas së cilës nga Këshilli Votues i kanë dhënë 7 fletvotime, e ai i papenguar ka votuar në të gjitha fletëvotimet.

Në Radovish, me leje të Këshillit Zgjedhor, një person ka votuar për së paku 30 qytetarë, të cilët janë paraqitur si analfabetë.



СЕРВИСНА ПРАВИЛА



Përgjigjja e institucioneve

Lëshimeve të shumta gjatë organizimit dhe realizimit të zgjedhjeve, si dhe rasteve të shumta të shkeljes së Kodit Zgjedhor dhe ligjeve të tjera gjatë realizimit të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të jashtëzakonshme në vitin 2014, për të cilat në mënyrë publike dhe të argumentuar bënte me dije Civili, organet shtetërore dhe VMRO-DPMNE-ja, partia në pushtet, iu përgjigjën me sulme të vrazhda dhe politikisht të motivuara kundër Civilit dhe me diskualifikim personal dhe me gjuhë urrejtjeje kundër kryetarit të Civilit, Xhabir Derallës.

Përgjigje të tjera (relevante) nuk pati. Institucionet të cilave iu bë thirrja që të përgjigjen për dyshimet serioze për mungesat dhe parregullsitë gjatë procesit zgjedhor, kryesisht e mohonin ekzistimin e tyre, përgjegjësinë ia hidhnin njëri-tjetrit ose problemet i shpjegonin me kohëra të tjera dhe garnitura udhëheqëse të tjera.

Kështu, MPB-ja, në disa raste e hodhi përgjegjësinë mbi Komisionin Shtetëror Zgjedhor, por, në një rast e vendosi përgjegjësinë edhe në një kohë tjetër, duke i bërë përgjegjëse zgjidhjet ligjore të sjella në kohën e pushtetit të LSDM-së, para më shumë se tetë vjet, gjegjësisht udhëheqësit paraprake të MPB-së, gjithsesi, në kohën e LSDM-së. Gjatë kësaj, MPB-ja, edhe pse e pranoi ekzistimin e 54 votuesve të paqenë në Kisella Vodë, e sulmoi Civilin me një gjuhë të vrazhdë dhe diskredituese se kjo organizatë e manipulon publikun?!

Qendra për Komunikim e VMRO-DPMNE-së, në ueb-faqen zyrtare të partisë, në disa raste u përpoq ta diskreditojë Civilin dhe udhëheqësinë e tij dhe ta përshkruajë si organizatë "sorosoide", e cila punon në favor të opozitës.

Portali "Kurir", si dhe disa portale të tjerë të ngjashëm me të për nga politika redaktuese, të njohur për lojalitetin e pazezerv ndaj VMRO-DPMNE-së në pushtet, në vazhdimësi përpiqeshin ta diskreditojnë Civilin, me përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe me shpifje. Një ilustrim i mirë për këtë propagandë të ndyrë është shkrimi i publikuar në mesditë, në vetë ditën e votimit në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, gjegjësisht të zgjedhjeve parlamentare të jashtëzakonshme, në të cilin kryetari i Civilit Xhabir Deralla, në kontekstin "tradhtar" kualifikohet si "shqiptar", "sorosoid", "mbrojtës i të drejtave të shqiptarëve", "mbrojtës i të drejtave të homoseksualëve" dhe si "grushti goditës i LSDM-së".⁸

⁸ <http://kurir.mk/makedonija/vesti/156094-Koja-e-nevladinata-Civil>

Dhuna

Dhuna në këto zgjedhje më shumë ishte e pranishme si një kanosje latente gjatë tërë procesit zgjedhor, edhe pse disa herë u regjistruan edhe raste të përdorimit të dhunës në formën fizike më të drejtpërdrejtë.

Për shembull, i këtillë është rasti me sulmin e njërit nga prijësit e partisë – partner koalicioni në Qeveri, Amdi Bajram, mbi nënkryetaren e LSDM-së opozitare, Radmilla Sheqerinska, në rrethin e parë zgjedhor më 13 prill, në ambientet e një vendvotimi në ShF “Vëllezërit Ramiz Hamid” në Komunën Shuto Orizar të Shkupit.

Është regjistruar edhe një sulm fizik i aktivistëve të VMRO-DPMNE-së mbi aktivistët që shoqëronin kandidatin presidencial Stevo Pendarovski, gjatë fushatës zgjedhore mes dy rrahëve, më 16 prill, në rr. “Gjorgji Kapçev”, në lagjen Lisiçe, në komunën Aerodrom të Shkupit.

Gjatë procesit zgjedhor dhe gjatë vetë ditëve të votimit, u regjistruan rreth dhjetë rrahje dhe konflikte më të vogla fizike ose konfrontime mes aktivistëve partiakë në Pllasnicë, Strumicë, Kumanovë, Lubanc, fsh. Bërnjarc, Radishan dhe Gazi Babë.

Si një incident posaçërisht simptomatik duhet të përmendet rrahja në Radishan më 13 prill. Atje, aktivistë të VMRO-DPMNE-së fizikisht sulmuan një familje shqiptare, në një rast të qartë të dhunës me urrejtje etnike. Në këtë incident policia nuk reagoi me kohë.



Presione mbi vëzhguesit e Civilit

Gjatë këtyre zgjedhjeve, regjistruam gjithsej 21 rast të pengimit të vëzhguesve të Civilit në ditët e zgjedhjeve më 13 dhe 27 prill.

Pengimi përfshinte moslejimin e pranisë së vëzhguesve në vendvotime, legjitimim joligjor, dezinformim, përzierje në punë, si dhe kanosje dhe ofendime. Në një rast kur vëzhgues tanë kanë qenë verbalisht të sulmuar, janë shprehur edhe ofendime në bazë etnike.

Në më shumë raste, vëzhguesit tanë janë pyetur pa fund nga ana e anëtareve të komisioneve zgjedhore ose nga vëzhgues dhe aktivistë të partisë në pushtet, që pastaj të trajtohen me përçmim. Në një pjesë të madhe të pengimit, anëtarët e komisioneve zgjedhore, e në tre raste edhe zyrtarë policie, kanë kërkuar dokumentacion plotësues nga vëzhguesit tanë, në kundërshtim me Kodeksin e Vëzhgimit. Pasi që është cituar Kodeksi, ata në të shumtën e rasteve janë tërhequr.

Në dy raste të ndara, kur vëzhguesi ynë ka qenë i larguar nga vendvotimi me arsyetime të paqëndrueshme, vëzhguesit tanë ktheheshin pas intervenimit telefonik të Civilit në KShZ. S'kemi informata se çfarë ka ndodhur gjatë kohës kur vëzhguesit tanë nuk kanë qenë në vendvotimet në të cilat kanë qenë të vendosur.

Në dy raste të ndara, regjistrohen përpjekje për sulm fizik mbi vëzhguesit tanë. Përpjekje për sulm fizik mbi vëzhguesit tanë kishte në komunat Shuto Orizar dhe Strumicë.

Posaçërisht indikativ është rasti në Strumicë. Një grup i aktivistëve të tërbuar të partisë në pushtet, në mënyrë verbale u janë kanosur me sulm fizik dy vëzhgueseve të Civilit. Edhe pse kanë kërkuar mbrojtje policore, ato kanë qenë të refuzuara. Ekipi ynë u largua falë disa qytetarëve kalimtarë qëllimshëm, të cilët janë gjetur aty gjatë incidentit.

Edhe pse Civili reagoi në formë të shkruar, si dhe publikisht, para mediave, KShZ-ja nuk u prononcua as rreth shkresave të Civilit për pengimin e vëzhguesve të tij legalisht të regjistruar dhe të akredituar.

Civili dhe KShZ-ja

Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ) nuk do t'i shqyrtojë parregullsitë dhe vërejtjet të cilat i dërgoi shoqata joqeveritare Civil, ditën e zgjedhjeve. Komisioni vërejtjet e Civilit i konsideron si informata dhe nuk mund të vendosë asgjë rreth tyre. Këtë e deklaroi kryetari i KShZ-së, Nikolla Rillkovski, në një nga konferencat për shtyp të KShZ-së.

“Nga shoqata joqeveritare Civil morëm një numër të madh vërejtjesh, por kjo për ne është dhënie material të karakterit informativ. Këto nuk janë të dhëna për të cilat ne do të vendosim konkretisht. Ne vetëm do të vendosim për atë që do ta pranojmë si e dhënë zyrtare nga shkresat”, deklaroi Rillkovski.

Nënkryetari i KShZ-së, Subhi Jakupi, për Civil Media deklaroi se organizata Civil nuk është subjekt aktiv në zgjedhjet dhe se vetëm partitë politike mund t'i përdorin vërejtjet për të cilat bëri me dije Civil.

“Ju nuk jeni aktivë në zgjedhje, edhe pse keni vëzhgues. Raportet tuaja nuk janë obliguese që ne të reagojmë, ato janë vetëm informata. Nuk është obligim i yni që të reagojmë. Partitë politike, në afat prej 48 orë, mund t'i marrin vërejtjet tuaja si informata dhe të reagojnë”, deklaroi Jakupi.

Civili KShZ-së i dërgoi shkresë e cila përmbante pothuajse 250 raste të parregullsive ditën e votimit. Dy vërejtje dhe një raport për parregullsi iu dërguan KShZ-së edhe gjatë fushatës zgjedhore, gjegjësisht një ditë pas ditës së votimit në rrethin e parë të zgjedhjeve.

Hajde, edhe pak ka mbetur!



Vëzhgimi pasgjedhor

Frikë, shuarje të burimeve të vetme të ekzistencës së atyre që mendojnë ndryshe dhe inspeksione në çdo hap mund të vëreheshin në një numër të madh të komunave në vend në periudhën pasgjedhore. Ekipi mobil i Civilit vizitoi 15 komuna anembanë vendit në periudhën pasgjedhore dhe arriti deri te të dhënat për fate njerëzore të numërta dhe bisedoi me njerëz të ballafaquar me frikë për ekzistencën e vet, për shkak se kanë menduar ndryshe ose gjatë zgjedhjeve nuk kanë vepruar ashtu siç u është urdhëruar nga ana e pushtetit.

Një nga fatet e tilla është ai i familjes së S.J. nga një komunë në jug-lindje të Maqedonisë, të cilët tekstualisht mbetën pa ekzistencë, saktësisht një ditë pas zgjedhjeve. Të ardhurat e vetme kjo familje katëranëtarëshe i ka siguruar nga një shitore e vogël mëhale, të ardhura nga të cilat mezi kanë mundur të mbijetojnë. Duke folur në mënyrë anonime, për shkak të rrethanave, kjo familje vendosi të na e rrëfejë rrugëtimin e tyre, të shkaktuar nga një arsye e vetme – nuk kanë qenë anëtarë të partisë në pushtet. Që të nesërmen, pas përfundimit të zgjedhjeve më 27 prill, një anëtar i dalluar i VMRO-DPMNE-së nga komuna e ka vizituar këtë familje.

“Është qytet i vogël, njihemi që të gjithë. Të gjithë e dinë se nuk jemi anëtarë të VMRO-DPMNE-së dhe gjithmonë ukemi qenë halë në sy. Ai hyri në shitoren tonë dhe na u drejtua me fjalët: ‘Lidhja juaj me LSDM-në nuk është gjë e mençur. Më mirë e keni që tani ta mbyllni shitoren’, rrëfen S.J.

Është krijuar një huti dhe pabesi në familje, shitorja e së cilës ka punuar më shumë se një dekadë.

“Nuk dinim ç’të bëjmë. Presione kemi patur edhe më parë, por ajo që tani e dëgjuam ishte e tmerrshme. Jemi të vetëdijshëm se të nesërmen në derë do të na priste inspeksioni dhe është më se e qartë se nëse dëshirojnë t’ju gjejnë ndonjë gjë – do t’ju gjejnë! I thashë burrit se dëm më të madh se kaq nuk mund të na bëjnë. Vërja drynin derës. Vendosëm të heqim dorë nga e vetmja gjë që na sillte të ardhura në shtëpi. Ja ku jemi tani, pa asgjë. Shpresoj se tani janë të lumtur dhe se nuk do t’u pengojmë më”, rrëfen ajo me lot në sy.

Anëtarët e Ekipit Mobil të Civilit e përshkruan këtë dhe shumë takime të tjera me qytetarët nëpër Maqedoni, me fjalët “sundim i frikës”.

Rasti të cilin këtu e paraqitëm është ilustrim për dhjeta raste në të cilat Ekipi Mobil mori deklarata dhe të dhëna në turnenë e shkurtër anembanë vendit.

Ndoshta tingëllon e habitshme që njeriu të heqë dorën nga ekzistenca vetëm për shkak të një kanosjeje, por, nga ajo që në terren e pa ekipi i Civilit, në qytetet më të vogla në vend, atmosfera e këtillë paszgjedhore bëhet një paraqitje "normale". "Më mirë ta mbyll shitoren, sesa të duroj kanosje për fëmijët e mi apo të ballafaqohem me inspeksione dhe presione të përditshme", u ka theksuar S.J. anëtarëve të Ekipit Mobil të Civilit, gjatë ndarjes.

Me situata të këtilla dhe të ngjashme të presioneve dhe kanosjeve paszgjedhore Ekipet Mobile të Civilit u ballafaquan edhe gjatë vëzhgimit paszgjedhor në Shtip, Strumicë, Kavadar, Prilep, Manastir, Resnjë, Ohër, Gjevgjeli, Strugë, Kërçovë, Tetovë, Gostivar, Bërvenicë, Koçan dhe Negotin. Menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, inspeksionet komunale dhe shtetërore u lëshuan nga ana e pushtetit në një sulm "ndëshkues" politik nëpër barnatore, shitore mëhalle, floktore dhe biznese të vogla të tjera në rrethet edhe ashtu të varfëra. Bizneset e vogla, thonë qytetarët, janë të parat të goditura në periudhën paszgjedhore.

Mes popullit ekziston përshtypja se madje edhe shkyçja e rrymës elektrike menjëherë pas zgjedhjeve është selektive, lajmërojnë vëzhguesit e Civilit, në bazë të dëshmimeve të qytetarëve. "Nëse s'je me ta, do të mbetesh pa rrymë. Nëse je me ta, do të të tolerojnë", na thonë burimet.

Në të gjitha takimet me qytetarët, vëzhguesit e Civilit konstatuan gjendje të cilat çojnë drejt presionit të shtuar mbi qytetarët dhe të frikës gjerësisht të përhapur. Në një numër të madh të rasteve, njerëzit kanë frikë të flasin, e nëse vendosin ta bëjnë këtë, kanë kujdes për vendin dhe kohën e takimit, lusin që të mos zbulohet identiteti i tyre nga frika, siç thonë, nga hakmarrja.

Regjistrohet edhe revanshizmi ndaj atyre të cilët nuk kanë votuar ose ndaj atyre të cilët nuk u kanë ndihmuar partive të koalicionit në pushtet gjatë zgjedhjeve. Regjistrohet rritja e punësimeve partiake paszgjedhor, duke përfshirë edhe ato në kompanitë private, të cilat janë nën presionin e partive në pushtet.

Pas zgjedhjeve, sidomos në vendet më të vogla, makineria propagandistike e pushtetit gjerësisht e promovonte qëndrimin se VMRO-DPMNE-ja është e pamposhtshme. Kjo shoqërohet me thirrje qytetarëve që t'i bashkohen partisë në pushtet dhe të marrin librezat partiake të saj. Nëse nuk e bëjnë këtë, qytetarëve u drejtoheshin kanosje se do t'i humbin vendet e punës, si dhe benefitet tjera ligjore, të cilat i gëzonin me të drejtë.

Javëve pas përfundimit të zgjedhjeve, shumë bujq ishin në pritje të pagesës së subvencioneve, të cilat u ishin premtuar para zgjedhjeve. Mes bujqve ndjehej nervozizmi, sepse ende nuk kishte ndonjë sinjal se kjo do të ndodhë.

Një numër i madh i vullnetarëve në administratën publike shpresonin se do të marrin vendime për punësim të përhershëm. Vetëm një pjesë e tyre do të pranohen në punë, gjegjësisht ata të cilët deri në fund i kanë realizuar aktivitetet e partisë, duke përfshirë edhe listat me "votues të sigurt" gjatë procesit zgjedhor.

**Një-dy-nj-dy...
Shkojmë të gjithë
së bashku! "Denes nad
Makedonija..."**



Ekipet e Civil – Qendrës për Liri, vullnetarët dhe aktivistët, koleget dhe kolegët nga një sërë organizata joqeveritare nga mbarë vendi, si dhe një numër i madh qytetarësh, dhanë kontributin e tyre personal dhe profesional për projektin Zgjedhje të lira 2014. Me çmim të shumë sakrificave dhe rreziqeve, objektivi ynë kryesor ishte faktet dhe e vërteta.

Nevoja për zgjedhje demokratike, të lira dhe pa dhunë është tepër e madhe për t'u siguruar sundimi i drejtësisë dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ky projekt la prova dhe dëshmi për një kohë turbulente dhe krizë të thellë politike në historinë më të re të Republikës së Maqedonisë.

Implementimi, metodologjia dhe përkrahja e projektit “Zgjedhje të Lira 2014”

Projekti “Zgjedhje të lira 2014” siguroi monitorim dhe analizë të gjendjes politike dhe proceseve shoqërore në kontekst të zgjedhjeve. Ekipet e ndryshme të Civilit mbledhën një material informativ të begatshëm, me vëzhgimin e përditshëm të gjendjes anembanë vendit. Ky material, i sistematizuar dhe i nënshtruar analizës gjithëpërfshirëse dhe të thellë, paraqet dëshmi për gjendjet në Republikën e Maqedonisë dhe një dokument i cili mund të shërbejë si bazë për vëzhgim të mëtutjeshëm, por edhe si udhëheqës drejt ndryshimeve pozitive në shoqëri dhe në shtet.

Vëzhgimi, puna mediatike dhe analizat e Civilit siguruan një informatë jopartiake, objektive dhe të paanshme për procesin zgjedhor dhe proceset dhe ngjarjet politike të përafërta gjatë periudhës nga nëntori 2013 deri në fund të majit 2014.

Një kohë të gjatë para fillimit të projektit, Civili formoi një ekip me vëzhgues afatgjatë, të cilët punonin në bazë vullnetare, deri në fillim të projektit. Pas fillimit të projektit, ekipi i vëzhguesve afatgjatë u rrit dhe u krijua edhe ekipi i vëzhguesve afatshkurtër. Njëkohësisht, u krijuan edhe Ekipet Mobile për vëzhgim dhe përkrahje, roli i të cilëve, mes tjerash, ishte që t’i kontrollojnë faktet e prezantuara nga vëzhguesit dhe t’u japin përkrahje vëzhguesve të cilët ishin nën presion, si dhe t’i vizitojnë rajonet në të cilët kishte një numër të rritur të parregullsive zgjedhore.

Vëzhguesit ishin nga e gjithë Maqedonia, por evitohej që ata të jenë vëzhgues në komunat e veta. Ata shpërndaheshin në pjesë të tjera të vendit.

Këtu do të japim një përshkrim të reduktuar të metodologjisë, e cila, gjithsesi, përmban shumë më shumë detaje dhe e cila është ndërtuar mbi bazë të përvojës së Civilit, me projektet vëzhgues dhe mbikëqyrjen e proceseve zgjedhor gjatë viteve të kaluara.

Vetë procesi i vëzhgimit përfshinte elemente të punës vëzhguese, intervista individuale dhe grupore, komunikimin me palët e interesit dhe një sërë veprimesh të cilët mundësojnë qasje të tërësishme në gjendjet dhe rastet e mëvetësishme, të cilët zbuloheshin. Obligim i çdo vëzhguesi ishte që të dërgojë së paku dy raporte gjatë javës gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore, ndërsa në ditët e votimit ata

kishin obligim të dërgojnë raport në çdo dy orë ose më shpesh, deri te ekipi analitik i Civilit. Raportet dërgoheshin në formë të formularëve të plotësuar në formë elektronike apo të shkruar, si dhe me telefon, me dinamikë 24-orëshe.

Civili e dizajnoi edhe ueb-faqen Zgjedhje të Lira për paraqitjen e parregullsive zgjedhore në maqedonisht, shqip dhe anglisht, e cila ishte në disponim të të gjithë qytetarëve. Shkresat e qytetarëve i verifikonin Ekipet Mobile për vëzhgim dhe përkrahje të Civilit.

Paralelisht me formimin e këtyre strukturave, të cilat kishin për detyrë të vëzhgojnë dhe rregullisht t'i dërgojnë zbulimet e tyre, Civili krijoi edhe redaksi me gazetarë në kuadër të njësisë organizative Civil Media. Ky ekip i përbërë nga gazetarë profesionistë, çdo ditë e ndiqte punën e ekipeve vëzhguese dhe bënte përzgjedhjen e përmbajtjeve të cilat arrinin deri te ekipi analitik i Civilit.

Gazetarët shkonin pas gjurmëve të materialit informativ të vëzhguesve të Civilit dhe realizonin hulumtime gazetareske, pavarësisht punës së ekipeve vëzhguese. Gjithashtu, gazetarët e redaksisë së Civil Medias bënë një numër të madh të video intervistave me ekspertë, ndërsa u ofruan hapësirë të barabartë edhe përfaqësuesve politik, të cilët merrnin pjesë në garën zgjedhore. Në mënyrë plotësuese, redaksia publikoi edhe një sërë kontributesh, analizash dhe komentesh të tjera, në kontekstin e procesit zgjedhor.

Të gjitha përmbajtjet u publikuan në ueb-faqen e redizajnuar të Civilit (www.civil.org.mk), si dhe në on-line kanalet e tjera të organizatës, nën kushtet e licencës Creative Commons, gjegjësisht ishin në disponim falas dhe të tërësishëm për ribotim, për të gjithë mediat e tjera. Në këtë kuptim, kishte mbi 500 marrje të përmbajtjeve të botuara nga Civili në të gjitha mediat në vend, por edhe jashtë vendit.

Një ekip i posaçëm për marrëdhënie me publikun u formua me detyrë për të organizuar press-konferenca dhe brifingje për mediat dhe t'i promovojë aktivitetet e on-line produksionit të Civilit, me të cilën gjë kontribuoi për forcimin e vetëdijes publike për kulturën zgjedhore.

Ekipi për marrëdhënie me publikun i Civilit, për tre muaj organizoi mbi njëzet press-konferenca dhe mbajti rreth 100 brifingje të mëvetësishëm. Njëkohësisht, Civili hapi press-qendër në GEM-Klub në Shkup ditët e votimit, të cilat ishin të hapura nga 17 orë, ndërsa paraqitjet mediatike ishin në disponim drejtpërdrejtë, nëpërmjet video strimingut, të cilin e siguroi ekipi i MOF Radios.

Gjatë realizimit të projektit, sidomos në ditët e votimit, e çmueshme ishte përkrahja eksperte e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM.

¹ www.slobodniizbori.info, www.zgjedhjetelira.info, www.freeelections.info

Projektin “Zgjedhje të Lira 2014” e përkrahën: Ambasada e ShBA-ve në Shkup, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Ambasada Gjermane në Shkup dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni, si dhe organizata gjermane Forum ZFD, me donacione në lartësi totale prej 57.811 euro.

Përkrahje të madhe dhe të rëndësishme të këtij projekti dha edhe një numër i madh qytetarësh dhe organizatash të shoqërisë civile, të cilët ekipeve të Civilit u ndihmuan me informata, logjistikë dhe përkrahje morale, për të qëndruar në përpjekjet e veta.

Civil – Qendra për Liri, për projektin “Zgjedhje të Lira 2014” u përpoq të kontribuojë për demokracinë, zgjedhjet e lira dhe jo të dhunshme, si dhe për sundimin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky projekt la dëshmi për një kohë turbulente dhe një krize politike të thellë në historinë më të re të Republikës së Maqedonisë.



Ndikimi i Civilit në Internet hapësirën

Ueb-faqja e Civilit u sendërtua me softuer më të ri dhe mjete shtesë që e pasuruan përvojën shfrytëzuese. U bënë një sërë modifikimesh, optimizime dhe ridisnjim, që përshtatet me të gjitha mjetet elektronike (desktop-kompjuterë, laptop, tablete, smart-fon), me çka u përkujdesëm për distribuim të garantuar të përmbajtjeve pa varësisht se prej nga u qasen vizitorët – në lëvizje, nga autobusi, nga kafiteria, vendi i punës, shtëpia – vetëm me një klik larg tyre.

Përveç ueb-faqes zyrtare të organizatës, Civili krijoi ueb-faqe në më shumë gjuhë për projektin “Zgjedhje të lira 2014”, e promovuar në prag të zgjedhjeve. Në të qytetarët kishin mundësi të paraqesin parregullsi, të informohen për të drejtat e tyre dhe ta ndjekin drejtpërdrejt transmetimin nga pres-konferencat tona në ditët e votimit ose t’i rishikojnë më vonë xhirimet nga video-arkiva jonë.

Kjo vegël u tregua si jashtëzakonisht produktive në diseminacionin e të dhënave të prezentuara nga pres-konferencat e Civilit deri te mediumet dhe gazetarët, të cilët për shkak të vëllimit të punës së tyre në ditët e votimit nuk arrinin që të jenë fizikisht të pranishëm në pres-qendrën, porse i ndiqnin transmetimet e drejtpërdrejta nga ueb-faqja.

Në mbi 500 tituj në internet-portalet e medias Civili përdoret si referencë.

Statistikat për muajt prill dhe maj, kur puna e Civilit ishte më dinamikja, shënojnë mbi 35.000 vizita respektivisht interaksion të publikut me ueb-faqen e Civilit, ndërsa numri i faqeve individuale që janë shfletuar kalon numrin 80.000, apo mesatarisht nga dy faqe për vizitë. Rreth 88% të vizitorëve kanë qenë nga Republika e Maqedonisë, ndërsa tjerët 12% nga 93 vende të botës. Duke shkuar më thellë në statistikat demografike për vizitorët, nga territori i Republikës së Maqedonisë më në numër janë vizitat

nga Shkupi (66%), Manastiri (9%) dhe Shtipi (6%), ndërsa numri i përgjithshëm i qyteteve nga vendi dhe bota prej nga janë vizituar internet adresat e Civili është mbi 940 qytete. Numri më i madh, ose 77% të vizitorëve, vizitat i kanë realizuar duke shfrytëzuar kompjuterët e vet personalë, ndërsa 23% përmes tableteve dhe smart-fonëve.

Përdorimi i rrjeteve sociale luajti rol kyç në animimin e publikut dhe gjenerimin e komunikacionit drejt ueb-faqeve. Pothuajse 66% për qind të vizitave janë realizuar përmes linqeve të shpërndara me miqtë dhe përcjellësit e shfrytëzuesve, nga të cilat 97% në Facebook, diç më pak se 3% në Twitter dhe një pjesë tepër e vogël në rrjetet tjera (Google+, LinkedIn etj.). Pjesa tjetër e komunikacionit vjen nga vizitat e drejtpërdrejta të internet adresave tona (20%), kërkimet organike në internet broserët (8%), linqe referente nga ueb-faqe tjera (5%) dhe 1% nga burime tjera.

Një nga publikimet më të popullarizuara nga redaksia informative, sipas vizitueshmërisë, është storja "Zbulohen mijëra votues në Qendër" nga gazetarja Meri Jordanovska nga ekipi i Civil Media, e botuar më 25 prill 2014. Teksti pati 2.784 vizita, ndërsa është shpërndarë 428 herë.

Përmbajtja e dytë për nga popullariteti është publikimi "Blerja e votuesve", video-material nga 20 prilli, që e bëri një nga vëzhguesit e Civilit. Ky kontribut ka 2.045 vizita, ndërsa është ndarë 355 herë.

Vendi i tretë i takon përmbajtjes jopopullore "Deklaratë e ombudsmanit Ixhet Memeti për parregullsitë gjatë votimit në burgjet" nga 26 prilli. Ky tekst u vizitua 1.701 herë, ndërsa u shpërnda 244 herë.

Këto publikime në ueb-faqen tonë, përveç që vizitoheshin dhe shpërndaheshin, gjithashtu shkaktuan interesim të madh te media, të cilat, ndërkaq, rregullisht kishin brifingje nga Civili me dërgimin e buletinit ditor me përmbajtjet e publikuara nga redaksia informative e Civil Media.

Video-produksioni i pasur për projektin "Zgjedhje të lira 2014" që u plasua në internet përmes YouTube kanalit të Civilit, gjithashtu u tregua si popullar dhe tërheqës për publikun. Videot e vendosura janë shikuar mbi 35.000 herë, ndërsa vizitorët kanë kaluar mbi 100 mijë minuta në shikimin e tyre.



civil.org.mk
civil.mk
civil.com.mk
slobodniizbori.mk
facebook.com/civil.mk
twitter.com/CivilMacedonia
youtube.com/civilorgmk
soundcloud.com/civil-org-mk
plus.google.com/+CivilCenterforFreedom



2014 СЛОБОДНИ ИЗБОРИ
ЗГЈЕДНЈЕ ТЌ ЛИРА
WWW.CIVIL.ORG.MK





ПОЛИЦИЈА

ПОЛИЦИЈА

ПУСТЕЊ

★

11

9

10

